

V E N D I M
Nr.619, datë 19.9.1996

DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në zbatim të neneve 25, 27 e 34, pika 3, të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe të sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjithë shtetasit shqiptarë, mbi moshën 16 vjeç, duhet të pajisen me dokument identifikimi të lëshuar nga organet kompetente të shtetit shqiptar.

Si dokumente identifikimi konsiderohen:

- Letërnjoftimi
- Pasaporta për jashtë shtetit
- Certifikata personale me fotografinë e personit
- Libreza ushtarake.

2. Shtetasit shqiptarë janë të detyruar t’i mbajnë me vete dokumentet e identifikimit. Në mungesë të letërnjoftimit, shtetasit detyrohen të mbajnë një nga dokumentet e tjera të identifikimit.

3. Të gjithë shtetasit shqiptarë detyrohen të paraqesin dokumentet e identifikimit sa herë që u kërkohen nga organet e policisë.

Mosmbajtja dhe mosparaqitja e dokumenteve të identifikimit nga shtetasit shqiptarë pas datës 10.10.1996, kur këto shkelje formojnë kundërvajtje sipas dispozitave të ligjit “Për policinë e rendit”, dënohet nga punonjësit e policisë me gjobë në masën e përcaktuar në ligj.

Refuzimi nga ana e shtetasve shqiptarë për të mos paraqitur dokumentet e identifikimit, mund të sjell shoqërimin e tyre në organet e policisë.

4. Nga ana e zyrës së gjendjes civile të merren masat e nevojshme administrative për pajisjen e shtetasve shqiptarë me certifikatë personale me fotografi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal, prefekturat, organet e pushtetit lokal, organet e policisë, si dhe zyrat e gjendjes civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi